



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 12/2 prot.

Tiranë më 29.01.2018

VENDIM

Nr. 01, datë 29.01.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1522 Prot., datë 21.11.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Agjencia e Shërbimit Arkeologjik" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me emailin e datës 26.10.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me projektin privat "Godinë 5 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", lagja nr. 1, rruga "Nako Spiro" dhe rruga "De Rada", Durrës, zona arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti "Fakle" shpk, si më poshtë vijon:

1. *Konceptin e gërmimit arkeologjik të paraqitur nga firma e licensuar në arkeologji "A.K.eR".*
2. *Akt-marrëveshjen tre palëshe të lidhur midis shoqërisë së licensuar në arkeologji, Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës (DRKK) dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.*
3. *Procesverbalin e plotësuar nga firma e licensuar në arkeologji "A.K.eR".*
4. *Procesverbalin e plotësuar nga DRKK Durrës.*
5. *Procesverbalin e plotësuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.*

6. *Raportin e dorëzuar nga firma e licensuar në arkeologji "A.K.eR", pas gërmimit arkeologjik.*

Me shkresën nr. 13/1 Prot., datë 07.11.2017, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë me anë të vendimit nr. 27, datë 09.02.2017 ka marrë projektin e sipërcituar dhe me vendimin nr. 52, datë 24.03.2017 ka miratuar konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit. Procedura e shqyrtimit të projektit nuk ka përfunduar ende dhe do jetë Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë që do të përcaktojë vijueshmërinë e zhvillimit të tij".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1522 Prot., datë 21.11.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 308 datë 07.12.2017 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, përfaqësues të Autoritetit Publik dhanë argumentat e tyre lidhur me objektin urdhër inspektimi.

Për sa i përket pikës së parë të kërkesës *"Koncepti i gërmimit arkeologjik i paraqitur nga firma e licensuar në arkeologji "A.K.eR", u sqarua se ky informacion nuk mund t'i vihet në dispozicion kërkuarit, sepse ky koncept është projekt i hartuar nga subjekti privat i licensuar në arkeologji, i cili realizohet me fondet e investitorit privat "FAKLE" shpk dhe ruan të drejtën e autorit, bazuar në ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të lidhura me to", neni 8, pika 1, germa "h".*

Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA), me Vendimin 52 datë 24.03.2017, ka miratuar konceptin e gërmimit, në vijim të të cilit, subjekti kryen gërmimin arkeologjik të shpëtimit në terren. Rezultatet e gërmimit të shpëtimit janë paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e datës 31.10.2017 të KKA. Procedura e vendimmarrjes nuk është mbyllur ende, pasi KKA ka ngritur një grup pune me ekspertë për mbledhjen e një informacioni më të detajuar në terren.

Lidhur me pikën e dytë të kërkesës *"Akt-marrëveshjen tre palëshe të lidhur midis shoqërisë së licensuar në arkeologji, DRKK Durrës dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik",* sqarohet se kjo akt-marrëveshje është në proces zbatimi dhe i referohet vetëm palëve nënshkruese në marrëveshje, bazuar në ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar, neni 43, mbasi aty përshkruhen të drejta dhe detyrime të palëve nënshkruese.

Dokumentacioni i kërkuar në pikat 3 dhe 4 të kërkesës *"Procesverbali i plotësuar nga firma e licensuar në arkeologji "A.K.eR" dhe "Procesverbali i plotësuar nga DRKK Durrës",* nuk disponohen nga Autoriteti Publik.

Për sa i përket pikës 5 në të cilën kërkohet *"Procesverbali i plotësuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik",* sqarohet se ky procesverbal i hartuar midis tre palëve në marrëveshje (e drejtë vetëm për palët në marrëveshje) përshkruan të dhëna teknike dhe

rezultate të cilat i përcillen KKA-së për shqyrtim dhe për të cilat nuk është marrë ende një vendim.

Informacioni i kërkuar në pikën 6 të kërkesës “Raporti i dorëzuar nga firma e licensuar në arkeologji “A.K.eR”, pas gërmimit arkeologjik”, nuk mund të vihet në dispozicion të kërkuarit, sepse ky raport është i hartuar nga subjekti privat i licensuar në arkeologji, i cili realizohet me fondet e investitorit privat “FAKLE” shpk dhe ruan të drejtën e autorit, bazuar në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të lidhura me to”, neni 8, pika 1, germa “h”. Gjithashtu, bazuar ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar dhe Rregulloren për ushtrimin e profesionit të arkeologut, të drejtën e publikimit dhe botimit të Raportit e ka autori brenda 5-viteve nga përfundimi i projektit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se “Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personalekur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 12 Prot., datë 04.01.2018, Komisioneri njoftoi palët në një seancë dëgjimore e cila u zhvillua me datë 15.01.2018. Gjatë seancës ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas shqyrtimit të ankimit, inspektimit të ushtruar, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se arsyetimi i Autoritetit Publik në lidhje me pikën 1, ku refuzohet vënia në dispozicion e dokumentit të kërkuar me argumentin se një gjë e tillë ndalohet nga dispozitat e Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, është i gabuar. Kjo për arsye se në parim kërkesa e ankuesit për t’u informuar nuk çënon apo zhvesh autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur atë.

Për më tepër koncepti i gërmimit arkeologjik është hartuar nga shoqëria e licensuar në bazë të kontratës trepalëshe (midis Autoritetit Publik, shoqërisë A.K.eR Shpk, në cilësinë e shoqërisë së licensuar dhe shoqërisë FAKLE shpk, në cilësinë e investitorit të projektit) me nr. 600 Prot datë 05.05.2017, për llogari të Autoritetit Publik në përmbushje të një detyrimi ligjor që i buron këtij të fundit nga ligji.

Pra, siç parashikohet në nenin 67 të Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” shoqëria A.K.eR Shpk (që pretendon të drejtat e autorit) ka kryer një procedurë të komisionuar nga Autoriteti Publik, e cila duhet të kryhej nga ky i fundit, por që për shkak të njohurive të posaçme që kërkon, i është besuar shoqërisë së licensuar e cila është shpërblyer për dokumentin e hartuar nga investitori i projektit, shoqëria “FAKLE” Shpk.

Sa më sipër shoqëria e licencuar i ka kaluar Autoritetit Publik në cilësinë e porositisit të drejtën e shfrytëzimit të veprës së tij, në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Në bazë të nenit 78 të Ligjit të sipër përmendur, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi në kuadër të një procedure administrative dhe për rrjedhojë kufizimet e pretenduara nga Autoriteti Publik nuk gjejnë zbatim.

Lidhur me pikën e dytë të kërkesës “*Akt-marrëveshjen tre palëshe të lidhur midis shoqërisë së licensuar në arkeologji*”, Komisioneri vlerëson se arsyetimi i bërë nga Autoriteti Publik për refuzimin e kërkesës është i gabuar. Kjo për faktin se për sa kohë palë në marrëveshje janë institucione publike dhe ajo është regjistruar pranë autoritetit publik dhe administrohet prej tij, ky dokument përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga administrimi i provave gjatë inspektimit, por dhe nga parashtrimet e Autoritetit Publik në aktet shkresore dhe gjatë seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit konstaton se informacioni i kërkuar në pikat 3 dhe 4 nuk disponohet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Megjithatë, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik duhet t’ia kishte kaluar kërkesën për informacion autoritetit që zotëron informacionin e kërkuar (në rastin konkret DRKK-së), si dhe të njoftonte lidhur me këtë fakt kërkuuesin e informacionit, duke i vënë në dispozicion kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.

Për sa i përket arsyetimit të Autoritetit Publik lidhur me pikën 5 të kërkesës për informacion, në të cilën kërkohet “*Procesverbali i plotësuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik*”, Komisioneri vlerëson se ky dokument zotërohet nga Autoriteti Publik dhe si i tillë përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Për më tepër sqarojmë se, për nga natyra e tij dokumenti i kërkuar nuk ka nevojë t’i nënshtrohet vendimmarrjes nga ana e KKA-së që të plotësojë kriteret për t’u konsideruar informacion publik.

Sa i përket argumentimit të Autoritetit Publik lidhur me pikën 6 të kërkesës për informacion të ankuesit, Komisioneri vlerëson se ky argumentim është i gabuar pasi dokumenti në fjalë nuk mund të klasifikohet si “vepër” në kuptim të nenit 8 të Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Në përfundim, rezulton se informacioni i kërkuar nga Z. në pikat 1, 2, 5 dhe 6 është i regjistruar pranë Autoritetit Publik dhe si i tillë administrohet prej tij duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e

regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik duhet ta vërë në dispozicion të kërkuarit informacionin e kërkuar në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me pikat 1, 2, 5 dhe 6 të ankesës së Z. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës Nr. 1522 Prot., datë 21.11.2017 të Z. , ndaj Autoritetit Publik “Agjencia e Shërbimit Arkeologjik”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 1, 2, 5 dhe 6 të kërkesës, dhe konkretisht: - 1) Konceptin e gërmimit arkeologjik të paraqitur nga firma e licensuar në arkeologji “A.K.eR”, 2) Akt-marrëveshjen tre palëshe të lidhur midis shoqërisë së licensuar në arkeologji, Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës (DRKK) dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, 5) Procesverbalin e plotësuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, 6) Raportin e dorëzuar nga firma e licensuar në arkeologji “A.K.eR”, pas gërmimit arkeologjik, - në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, brenda datës 05.02.2018

3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 3 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 26.10.2017, përkatësisht “Procesverbali i plotësuar nga firma e licensuar në arkeologji “A.K.eR” dhe “Procesverbali i plotësuar nga DRKK Durrës”.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u dha sot në datë 29.01 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

